



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 29

2002

Qershor

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8905, datë 6.6.2002	Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi.....	895
Ligj nr. 8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura.....	902
Ligj nr. 8908, datë 6.6.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”.....	915
Ligj nr. 8813, datë 13.6.2002	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”.....	916

**LIGJ**  
**Nr. 8905, datë 6.6.2002**

**PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DETAR NGA NDOTJA DHE DËMTIMI**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Mjedisi detar” është hapësira detare e Republikës së Shqipërisë, së bashku me faunën dhe florën, pasuritë e ujit, të sipërfaqes së fundit të detit dhe të nëntokës së tij, duke përfshirë edhe vijën bregdetare, plazhet, portet, radat dhe territoret tokësore të tyre, lagunat, grykëderdhjet e lumenjve, liqenet e vijës së ujit, që komunikojnë me detin.

2. “Burimet e detit dhe të bregdetit” janë të gjitha pasuritë minerare, llojshmëria biologjike, gjetjet arkeologjike, paleontologjike, që ndodhen në mjedisin detar.

3. “Ndotje” është futja nga njeriu, drejtpërdrejt ose tërthorazi, e lëndëve ose e energjisë në mjedisin detar, të cilat dëmtojnë burimet e detit dhe të bregdetit, ulin cilësinë e ujit të detit, rrezikojnë shëndetin e njeriut, pengojnë veprimtaritë detare dhe peshkimin.

3.1 “Ndotje e madhe” është ndotja komplekse dhe me shtrirje të gjerë, shmangia e së cilës kërkon masa të gjithanshme dhe operacione pastrimi.

3.2 “Ndotje e vogël” është ndotja me shtrirje të kufizuar, shmangia e së cilës përballohet me përdorimin e mjeteve e mundësive vendore.

4. “Hedhje në det” është hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lënde nga anijet, platformat, instalimet, si dhe nga bregdeti.

5. “Mbytje në det” është fundosja me dashje e anijes, e platformës, e instalimit, si dhe e çdo lloj ngarkese e pajisjeje.

Nuk është mbytje në det hedhja e materialeve që nuk bien në kundërshtim me ligjin dhe konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

6. “Lëndë të rrezikshme” janë lëndët që prodhimi, transporti, ruajtja, përdorimi ose shkarkimi i të cilave në mjedisin detar, si pasojë e vetive të tyre, dëmtojnë shëndetin e njeriut, cilësitë e mjedisit detar, florën, faunën dhe ulin cilësinë e jetës.

7. “Mbeturina” janë të gjitha llojet e mbetjeve, që vijnë nga zhvillimi i veprimtarive njerëzore, me përjashtim të substancave të radhitura në anekset, që i bashkëlidhen këtij ligji.

8. “Ujëra të ndotura” janë:

- a) ujërat e zeza;
- b) mbeturinat e lëngëta që rrjedhin nga çdo lloj burimi;
- c) derdhjet e lëngëta spitalore;
- ç) çdo mbeturinë tjetër, e përzier me ujërat e zeza.

9. “Veprimtaritë njerëzore” përfshijnë:

- a) lundrimin dhe transportin me anije e me mjete të tjera;
- b) shfrytëzimin e burimeve dhe të pasurive të detit e të funddetit;
- c) veprimtaritë ekonomike, tregtare, të shërbimeve të bregdetit;
- ç) mirëmbajtjen, riparimin dhe operacione të tjera ndihmëse për anije, platforma e instalime, që ndodhen në det e në bregdet;
- d) kërkimet shkencore për burimet e detit, të shtratit dhe të nëntokës së tij;
- dh) studimet gjeologjike, sizmike, oqeanografike, marrjen e mostrave, shpim-kërkimet.

10. “Platformë” dhe “Pontile” janë konstruksione të vendosura në det, për qëllime studimi, kërkimi ose shfrytëzimi.

11. “Instalime” janë pajisjet e vendosura në det, si tubacione, kablllo, linja, për të zhvilluar veprimtari të ndryshme.

12. “Djegje në det” është shkatërrimi i lirë termik në ujërat e mjedisit detar i mbeturinave dhe lëndëve të tjera të djegshme.

### Neni 3 Mbrotjtja

1. Mjedisi detar është pjesë e mjedisit të Republikës së Shqipërisë dhe në mbrotjtje të pastërtisë së tij veprojnë të gjitha aktet ligjore që mbrojnë mjedisin në Shqipëri dhe konventat, protokollet, marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

2. Organet shtetërore qendrore dhe vendore, organizatat shoqërore dhe shtetasit kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e mjedisit detar, si dhe ta mbrojnë atë nga ndotjet e dëmtimet.

3. Në mënyrë të veçantë, janë të detyruar të mbrojnë mjedisin detar dhe të zbatojnë dispozitat e këtij ligji:

- a) personat juridikë e fizikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, që e përdorin mjedisin detar ose ushtrojnë veprimtari të ndryshme në të;
- b) të gjitha veprimtaritë e instaluara në bregdet;
- c) çdo mjet lundrues, që ndodhet ose lundron nëpër mjedisin detar;
- ç) mjetet aeronautike, që fluturojnë mbi mjedisin detar.

## KREU II ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHFRYTËZIMIT TË MJEDISIT DETAR

### Neni 4 Administrimi

1. Mjedisi detar i Republikës së Shqipërisë është pronë shtetërore e patjetërsueshme.

2. Administrimi i tij bëhet nga organe shtetërore të caktuara me ligj. Askush tjetër veç tyre nuk ka të drejtë të autorizojë përdorimin ose shfrytëzimin e mjedisit detar.

Neni 5  
**Përdorimi dhe shfrytëzimi**

1. Mjedisit detar përdoret dhe shfrytëzohet për veprimtari ekonomike, tregtare, shkencore, shoqërore, sportive, turistike e ushtarake.
2. Përdorimi dhe shfrytëzimi i tij bëhen nga organet shtetërore, nga personat juridikë e fizikë, vendas ose të huaj, vetëm në kushtet e parashikuara me ligj.

Neni 6  
**Veprimtaritë e ndaluara**

1. Në mjedisin detar ndalohet:
  - a) hedhja e lëndëve dhe e mbetjeve të rrezikshme helmuese e plasëse;
  - b) hedhja e substancave dhe e lëndëve të përcaktuara në Aneksin I, që i bashkëlidhet këtij ligji;
  - c) derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura;
  - ç) hedhja e lëndëve dhe e materialeve të ngurta, të çfarëdo natyre dhe lloji, me përjashtim të mjeteve e pajisjeve të peshkimit dhe të lëndëve e mjeteve të nevojshme për ndërtimin e porteve, pontileve e konstruksioneve të tjera, sipas projekteve të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe në kushtet e përcaktuara prej saj;
  - d) hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lënde nga anijet, platformat, instalimet dhe nga bregdeti;
  - dh) transportimi i lëndëve dhe i mbetjeve të rrezikshme;
  - e) fundosja e anijeve, e ngarkesave dhe e mallrave të çdo lloji e tipi;
  - ë) fundosja dhe braktisja e çdo lloj instalimi, që ka shërbyer për veprimtari të ndryshme;
  - f) ndërtimi dhe vënia në funksionim e pajisjeve që lëshojnë rrezatim jonizues;
  - g) djegia e lëndëve dhe e materialeve të çdo lloji;
  - gj) hyrja në porte me ballaste të papastra e mjeteve detare të çfarëdo lloji, tipi e tonazhi;
2. Mbeturinat e përcaktuara në Aneksin II, që i bashkëlidhet këtij ligji, mund të hidhen në det vetëm me autorizim të Ministrisë së Mjedisit.

Neni 7  
**Autoriteti i kontrollit**

Kontrolli i mjedisit detar dhe i veprimtarive që zhvillohen në të ushtrohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Mjedisit, nga kapiteneritë e porteve, nga organet shtetërore që kanë licencuar veprimtaritë, si dhe nga organe të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 8  
**Objekti i kontrollit**

1. Kontrolli i Inspektoratit të Mjedisit është i përhershëm dhe i vazhdueshëm.  
Ai ushtrohet për gjendjen e cilësitë e mjedisit detar, për elementet e faktorët natyrorë e njerëzorë të tij, për të vëzhguar e regjistruar ndryshimet e tyre.
2. Inspektorati kontrollon ndikimet e veprimtarive në mjedisin detar, si i zbatojnë ato kërkesat e legjisllacionit mjedisor dhe kushtet e vëna në lejen mjedisore.
3. Për kryerjen e detyrave të tij, Inspektorati bashkërendon punën me kapiteneritë e porteve, me Inspektoratin e Peshkimit, me Policinë e Shtetit, si dhe me Rojat Bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

KREU III  
GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE

Neni 9

**Rregullat për administrimin e mbeturinave**

1. Në mjedisin detar grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të krijuara nga veprimtaritë e ndryshme dhe nga anijet që ndodhen ose lundrojnë në të, bëhen sipas kërkesave të këtij ligji dhe të akteve në zbatim të tij.

2. Rregullat për administrimin e mbeturinave në mjedisin detar përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mjedisit, të Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Neni 10

**Grumbullimi**

Platformat detare, anijet me tonazh bruto regjistër mbi 400 BRT, si dhe të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në mjedisin detar, detyrohen:

a) të pajisen me tanker për hedhjen e mbeturinave, kapaciteti i të cilit është në varësi të tipit të pajisjeve dhe të llojit të veprimtarisë;

b) të pajisen me sistem filtrues-ndarës të ujit nga hidrokarburet e përdorura;

c) të shënojnë në ditar ose në procesverbal operacionet që kryejnë për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave;

ç) të monitorojnë veprimtarinë që ushtrojnë dhe të publikojnë të dhënat e këtij monitorimi.

Neni 11

**Subjektet që largojnë mbeturinat**

1. Largimi i mbeturinave dhe i hidrokarbureve të përdorura, që rrjedhin nga kryerja e veprimtarive në mjedisin detar, bëhet nga persona fizikë e juridikë të specializuar për pastrim.

2. Personat fizikë dhe juridikë që administrojnë këto mbeturina pajisen me leje mjedisore.

3. Licencimi mbështet përdorimin e teknologjive më të mira, të mundshme për pastrim.

Neni 12

**Dorëzimi i mbeturinave**

1. Personat juridikë e fizikë, që ushtrojnë veprimtari në mjedisin detar, dhe anijet para hyrjes në port, dorëzojnë mbeturinat dhe hidrokarburet e përdorura te subjekti pastrues i licencuar.

2. Para se të marrë leje për të hyrë në portet e Republikës së Shqipërisë, kapiteni i anijes është i detyruar të dorëzojë në kapitenerinë e portit deklaratën për pastrimin e tankerave të anijes.

3. Kapiteneria e portit kontrollon anijen, për të vërtetuar saktësinë e deklaratës së kapitenit dhe gjendjen e tankerave.

KREU IV  
PËRBALLIMI I NDOTJEVE

Neni 13

**Njoftimi i ndotjes**

1. Çdo person që vëren ndotje të mjedisit detar është i detyruar të njoftojë kapitenerinë e portit ose organin shtetëror më të afërt.

2. Kapiteni i anijes, operatori i platformës dhe personi i barazuar me ta në veprimtaritë e tjera që zhvillohen në mjedisin detar, sapo vëren se mjedisi është ndotur me hidrokarbure ose lëndë të tjera të dëmshme, njofton kapitenerinë e portit.

3. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe të dhëna të tjera të njoftuesit;
- b) vendndodhjen e ndotjes;
- c) kohën e ndodhjes e të konstatimit;
- ç) përshkrimin e ndotjes;
- d) burimin dhe shkakun e ndotjes;
- dh) tipin dhe sasinë e ndotësit;
- e) kushtet e motit e të detit.

4. Kapiteneria e portit bën verifikimin e njoftimit dhe menjëherë vë në dijeni Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacioneve, Ministrinë e Mjedisit, si dhe qeverisjen vendore, në territorin e së cilës ka ndodhur ndotja.

#### Neni 14

##### **Pastrimi i ndotjes**

1. Personat fizikë dhe juridikë, që kanë shkaktuar ndotjen e mjedisit detar, detyrohen të pastrojnë zonën e ndotur, ta sjellin atë në gjendjen e mëparshme, si dhe të shpërblejnë dëmet.

2. Kapiteni i anijes, operatori i platformës, si dhe personi i barazuar me ta në veprimtaritë e tjera, në radhë të parë, janë të detyruar të marrin masat për pastrimin e ndotjes që kanë shkaktuar.

#### Neni 15

##### **Operacionet e pastrimit**

Në rast ndotjeje të madhe, gjendja përballohet me operacione pastrimi të cilat organizohen dhe zbatohen, sipas kërkesave të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”.

#### Neni 16

##### **Ndotja nga anijet ushtarake**

1. Kur mjedisi detar është ndotur nga anije ose instalime ushtarake, Inspektorati i Mjedisit njofton Ministrinë e Mbrojtjes, e cila merr masa për pastrimin e zonës së ndotur.

2. Kur ndotja shkaktohet nga anijet ushtarake të huaja, të cilat ndodhen, kalojnë ose marrin pjesë në stërvitje që zhvillohen në mjedisin detar, bëhet njoftim në rrugë diplomatike, ku paraqiten edhe kërkesat për pastrimin e ndotjes e për shpërblimin e dëmeve.

#### Neni 17

##### **Ndotja gjatë veprimeve luftarake**

Ndotja dhe dëmtimi i mjedisit detar nga anije, avionë e mjete të tjera të huaja ushtarake gjatë veprimeve luftarake, përbëjnë çështje parësore në bisedimet e pasluftës me shtetin, të cilit i përkasin mjetet që kanë shkaktuar ndotjen. Në bisedime paraqiten kërkesat për rikthimin e mjedisit detar në gjendjen e mëparshme dhe për shpërblimin e dëmeve.

## KREU V SANKSIONET

### Neni 18

#### **Kryerja e veprimtarive të ndaluara**

1. Ndaj subjektit që ushtron veprimtari të ndaluara nga neni 6 i këtij ligji, kur këto veprimtari përbëjnë vepër penale, Inspektorati i Mjedisit bën kallëzimin për ndjekje penale.

2. Kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, Inspektorati i Mjedisit vendos ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë dhe sekuestrimin e mjeteve e të pajisjeve me të cilat është shkaktuar ndotja; ndotja e vogël e përcaktuar në nenin 2 nënpika 3.2 gjobitet nga 10 mijë deri në 100 mijë lekë; ndotja e madhe e përcaktuar në nenin 2 nënpika 3.1 gjobitet nga 500 mijë deri në 1 milion lekë; hedhjet në det nga bregdeti gjobiten nga 100 mijë deri në 500 mijë lekë; hedhjet në det të lëndëve të rrezikshme, të përcaktuara në nenin 6, gjobiten nga 500 mijë deri në 1 milion lekë; ujërat e ndotura të përcaktuara në nenin 2 pika 8 gjobiten nga 100 mijë deri në 500 mijë lekë.

### Neni 19

#### **Veprimtari të tjera të ndaluara**

1. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) me gjobë nga 100 mijë deri në 1 milion lekë dhe pezullimin e veprimtarisë deri në 3 muaj, kohë brenda së cilës subjekti duhet të pajiset me leje mjedisore, kur ushtron në mjedisin detar veprimtari pa lejen mjedisore;

b) me gjobë nga 100 mijë deri në 1 milion lekë, në varësi nga llojet dhe përmasat e ndotjes dhe detyrimin për pastrimin e zonës së ndotur dhe sjelljen e saj në gjendjen e mëparshme, si dhe pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë, për aq kohë sa subjekti të marrë të gjitha masat për të eliminuar ndotjen, kur veprimtaria e subjektit ndot ose dëmton mjedisin detar;

c) pezullohet nga Inspektorati i Mjedisit për një muaj, kohë brenda së cilës subjekti duhet të plotësojë kërkesat, kur veprimtaria e pajisur me leje mjedisore, nuk përmbush kërkesat e nenit 10 të këtij ligji;

ç) me gjobë nga 100 mijë deri në 1 milion lekë, në varësi nga lloji dhe përmasat e ndotjes mosnjoftimi i ndotjes nga kapiteni i anijes, operatori i platformës, si dhe personi i barazuar me ta në veprimtaritë e tjera,

2. Organi që vendos gjobën dhe bën ekzekutimin e saj, si dhe pezullimin ose ndërprerjen e veprimtarisë, sipas këtij neni, është Inspektorati i Mjedisit.

3. Kur këto shkelje përbëjnë vepër penale, Inspektorati i Mjedisit bën kallëzimin për ndjekje penale.

### Neni 20

#### **Aktet nënligjore**

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministritë përkatëse të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

### Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3379, datë 24.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

## ANEKSI I

### SUBSTANCAT DHE LËNDËT QË NUK LEJOHEN TË HIDHEN NË DET

1. Përzierje të komponimeve organo-halogjenike, si dhe përzierje që mund të formojnë substanca të tilla në mjedisin detar, duke përjashtuar ato që nuk janë toksike ose që shndërrohen menjëherë në det në substanca biologjikisht të padëmshme, me kusht që këto të mos prishin shijen e organizmave të detit që përdoren për ushqim.
2. Përzierje të komponimeve organike të secilit, si dhe përzierje që mund të formojnë substanca të tilla në mjedisin detar, duke përjashtuar ato që nuk janë toksike ose që shndërrohen në det menjëherë në substanca të padëmshme, me kusht që këto të mos u prishin shijen organizmave të detit që përdoren për ushqim.
3. Mërkur dhe përzierje të mërkurit.
4. Kadmium dhe përzierje të kadmiumit.
5. Materiale plastike të qëndrueshme, të cilat pengojnë materialisht peshkimin ose lundrimin, dëmtojnë plazhet ose pengojnë përdorime të tjera të ligjshme të detit.
6. Naftë bruto dhe hidrokarbure që mund të dalin nga nafta, si dhe çdo përzierje tjetër që përmban një nga këto, e cila ngarkohet për t'u asgjësuar në det.
7. Mbeturina radioaktive të shkallës së lartë, të mesme e të ulët.
8. Përzierje acide dhe alkaline me përbërje dhe sasi të tillë që mund të dëmtojë seriozisht cilësinë e ujit të detit.
9. Materiale të çdo gjendjeje agregate, të prodhuara për luftën biologjike ose kimike, përveç atyre që nuk prishin shijen e organizmave të detit dhe nuk rrezikojnë jetën e njeriut.

## ANEKSI II

Mbeturinat, hedhja në det e të cilave kërkon autorizimin e Ministrisë së Mjedisit janë:

- 1.1. Arsenik, plumb, bakër, zing, berilium, krom, nikel, vanadium, selenium, antimon dhe përzierje të tyre.
- 1.2. Cianure dhe fluorure.
- 1.3. Pesticide dhe nënproduktet e tyre të ngjashme që nuk përfshihen në Aneksin I.
- 1.4. Kimikate organike-sintetike, përveç atyre që përmenden në Aneksin I, të cilat mund të japin pasoja të dëmshme për organizmat e detit ose prishin shijen e organizmave të detit që përdoren për ushqim.
  - 2.1. Përzierje acide dhe alkaline.
  - 2.2. Përzierje acide dhe alkaline që nuk përfshihen në Aneksin I.
3. Fuçi, mbeturina metalesh, si dhe mbeturina të tjera të rënda që mund të zhyten në fundin e detit, të cilat mund të paraqesin pengesa serioze për peshkimin dhe lundrimin.
4. Komponime që edhe pse të një natyre jotoksike mund të bëhen të dëmshme për shkak të sasirave në të cilat hidhen, që janë të prirura të zvogëlojnë në mënyrë serioze mundësitë e shfrytëzimit të detit për argëtim, ose rrezikojnë jetën e njeriut apo të organizmave të detit, si dhe pengojnë lundrimin.
5. Mbeturina radioaktive ose lëndë të tjera radioaktive që nuk përfshihen në Aneksin I.

**LIGJ**  
**Nr. 8906, datë 6.6.2002**

**PËR ZONAT E MBROJTURA**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**  
**Objekti i ligjit**

Ky ligj ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre; lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor; për informimin dhe edukimin e publikut dhe për përfitime ekonomike, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, nga popullsia vendore, nga sektori publik dhe privat.

**Neni 2**  
**Qëllimi i ligjit**

1. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës, në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura.
2. Zonat e mbrojtura krijohen për të siguruar ruajtjen dhe ripërtëritjen e habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore.
3. Ky ligj rregullon mbrojtjen e 6 kategorive të zonave të mbrojtura, që zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kategorizimi i zonave, statusi dhe niveli i mbrojtjes për secilën zonë mbështetet në kriteret e Qendrës Botërore të Ruajtjes së Natyrës (IUCN).

**Neni 3**  
**Përcaktimi i termave**

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Zona të mbrojtura” shpallen teritore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore.
2. “Shumëllojshmëria biologjike” (tani e tutje “biodiversiteti”) nënkupton larminë gjenetike, të llojeve dhe ekosistemeve.
  - 2.1 “Larmia gjenetike” nënkupton tërësinë e gjeneve brenda popullatës (popullatave) së një lloji të dhënë, të egër ose të zbutur. Ajo përfshin popullata të ndryshme të të njëjtit lloj ose ndryshueshmërinë gjenetike brenda një popullate.
  - 2.2. “Larmia e llojeve” nënkupton tërësinë e llojeve, të bimëve dhe të kafshëve.
  - 2.3. “Larmia e ekosistemeve” nënkupton tërësinë e tipeve të ekosistemeve.
3. “Sistem territorial i qëndrueshmërisë ekologjike të një peizazhi” është një kompleks i integruar së brendshmi i ekosistemeve natyrore dhe të ndryshuara, i aftë të ruajë qëndrueshmëri natyrore.

4. “Bioqendër” (qendra e biodiversitetit) është pjesa e peizazhit, ku sigurohen kushte afatgjata për riprodhimin dhe veprimtaritë jetësore të organizmave dhe për zhvillimin natyror të bashkësive të tyre.

5. “Biokorridor” (korridor biologjik) është segmenti i peizazhit, që lidh bioqendrat dhe mundëson migrimin e organizmave e të bashkësive të tyre, si dhe shkëmbimin e të dhënave gjenetike ndërmjet tyre.

6. “Habitat” është mjedisi i disa individëve bimorë ose shtazorë, i popullatave ose i bashkësive të tyre.

7. “Peizazh” është pjesë territori (përfshirë edhe hapësira detare e bregdetare), me karakteristika të veçanta të relievit, formuar nga një kompleks ekosistemesh të integruar në mënyrë funksionale, përfshirë edhe elementë të qytetërimit.

8. “Shpellë”, sipas këtij ligji, është një zgavër/hapësirë nëntokësore, më e gjatë se 5 m, e krijuar në kushte natyrore nën veprimin e faktorëve me origjinë joorganike.

9. “Shpellë vertikale” nënkupton hapësirën vertikale nëntokësore, e cila është më e thellë se 5 m.

10. “Ujëvarë natyrore” nënkupton një formacion ku uji, nën veprimin e forcave të natyrës, pa ndërhyrjen e njeriut, bie në shtratin e vet lumor nga një lartësi jo më pak se 1 m.

11. “Kanion” nënkupton një grykë të thellë, me shpate të rëna thikë, të krijuar nga proceset fiziko-natyrore, në bazën e së cilës, përgjithësisht, rrjedhin ujërat sipërfaqësore.

12. “Element i rëndësishëm i peizazhit” është një pjesë e peizazhit me vlera mjedisore, gjeomorfologjike ose estetike, që mbart një pamje tipike të peizazhit ose ndihmon në qëndrueshmërinë ekologjike të tij.

13. “Zonë buferike” quhet hapësira e kufizuar, në periferi të zonës së mbrojtur, që shërben për parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjikisht të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të një zone të mbrojtur.

14. “Ekosistem” është një njësi që përbëhet prej ndërveprimit të organizmave dhe mjedisit të tyre.

15. “Administrata e zonës së mbrojtur” është organi shtetëror i ngarkuar për ruajtjen dhe administrimin e një zone konkrete të mbrojtur.

16. “Leje mjedisi” është dokumenti zyrtar që lëshohet nga autoriteti mjedisor për veprimtari ekonomike e shoqërore, të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në mjedis, sipas kërkesave të legjislacionit për mjedisin.

17. “Rrjeti përfaqësues i zonave të mbrojtura” përbën sistemin e zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe brenda tij përzgjidhen ekosistemet, habitatet dhe peizazhet kryesore e përfaqësuese të vendit.

18. “Rrjeti ekologjik” përbën sistemin e zonave të mbrojtura, të njohura në bazë të rrjetit përfaqësues të tyre dhe të lidhura me biokorridore. Rrjetet ekologjike dallohen si sisteme vendore, rajonale dhe ndërrajonale.

19. Me “status të favorshëm të ruajtjes së një ekosistemi, habitati ose peizazhi” nënkuptohet se:

- a) shtrirja natyrore dhe sipërfaqet brenda kësaj shtrirjeje janë të qëndrueshme ose në rritje;
- b) struktura dhe funksionet e veçanta, të cilat janë të nevojshme për mirëmbajtjen afatgjatë, ekzistojnë dhe mund të vazhdojnë të ekzistojnë për të ardhmen e afërt;
- c) speciet e veta tipike kanë një status të favorshëm ruajtjetje.

#### Neni 4

#### **Kategoritë e zonave të mbrojtura**

1. Pjesë të rëndësishme ose të kërcënuara të territorit shpallen zona të mbrojtura, sipas këtyre kategorive:

- a) rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor/ (Kategoria I);
- b) park kombëtar (Kategoria II);

c) monument natyror (Kategoria III);  
ç) rezervat natyror i menaxhuar/zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV);  
d) peizazh i mbrojtur (Kategoria V);  
dh) zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).

2. Rreth një zone të mbrojtur mund të shpallet një zonë buferike.

3. Për çdo kategori të zonave të mbrojtura zbatohet një shkallë e caktuar mbrojtjeje.

#### Neni 5

#### **Rezervë strikte natyrore**

1. Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.

2. Në rezervën strikte natyrore zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara:

a) prerja e drurëve dhe e shkurreve;

b) përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike;

c) ndërtime të çdo lloji;

ç) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave;

d) gjuetia dhe peshkimi;

dh) ndezja e zjarreve; .

e) kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre;

ë) ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive;

f) kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës;

g) lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve;

gj) vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi;

h) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut.

3. Zonë buferike e rezervatit strikt natyror mund të shpallet territori rreth rezervatit, me gjerësi rreth 100 m nga kufiri i tij.

4. Veprimtaritë e tjera, që kërkohen të ushtrohen në rezervat ose në zonën e tij buferike, duhet të pajisen me leje mjedisi.

#### Neni 6

#### **Park kombëtar**

1. Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.

2. Në parkun kombëtar zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara:

a) shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitetin, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;

b) neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të parkut kombëtar;

c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;

ç) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;

d) ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;

dh) larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;

e) mbjellja e pyjeve monokulturë;

- ë) ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;
- f) lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara;
- g) gjuetia me ushqime të helmuara;
- gj) nxjerrja e mineraleve, gurëve, torfave me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;
- h) veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara;
- i) organizimi i garave me automjete e motoçikleta.

3. Në këtë zonë mund të ushtrohen, por vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi, veprimtaritë që synojnë:

- a) ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- b) ngritjen dhe funksionimin e objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje;
- c) programe kërkimore-shkencore dhe monitoruese;
- ç) veprimtari kërkimore shkencore, arkeologjike, paleontologjike dhe për mbartjen e gjetjeve të tilla.
- d) përdorimi ose magazinimi i përkohshëm i agrokimikateve;
- dh) veprimtari të tjera që nuk ndalohen shprehimisht nga pika 2 e këtij neni.

4. Administrata e ruajtjes së parkut mund të miratojë:

- a) kullotjen dhe kalimin e kafshëve shtëpiake dhe ngritjen e objekteve të lehta ose të përkohshme për mbajtjen e tyre;
- b) vendosjen e standave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave;
- c) vozitjen me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi;
- ç) fluturime joushtarake me helikopterë, balona, deltaplane etj;
- d) lëvizje dhe parkim automjeteve jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara;
- dh) ngjitje alpine, ski, kampingje dhe ndezje zjarri jashtë pikave të caktuara;
- e) mbledhje bimësh, frutash, farash e kërpudhash.
- ë) ushtrim veprimtarish të strukturave turistike sezonale që nuk kërkojnë zënie përfundimtare të tokës.

5. Kur administrata e ruajtjes së parkut vëren se cenohet qëllimi për të cilin ky park është shpallur park kombëtar, mund të kufizojë ose të ndalojë përkohësisht lëvizjen e mjeteve të transportit, gjuetinë e peshkimit dhe veprimtari të tjera të lejuara.

6. Zona buferike e parkut kombëtar mund të shpallet territori rreth parkut, me gjerësi rreth 50 m nga kufiri i tij.

#### Neni 7

### **Monument natyror**

1. Formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe geomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror.

2. Në një monument natyror zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

3. Në pajtim me shkallën e mbrojtjes së zonës Ministri i Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrin e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministrin e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, miratojnë rregulla të veçanta për kalim vizitorësh (turistë), për afate të shkurtra kohore.

#### Neni 8

### **Shpellat si monument natyror**

1. Shpellat shpallen monumente natyrore.

2. Hyrja në shpella, eksplorimi dhe studimi i shpellave bëhen me leje nga Ministria e Mjedisit, e cila jepet me propozimin e autoriteteve vendore përkatëse, institucioneve shkencore dhe organizatave jofitimprurëse të specializuara, në përputhje me rekomandimet e tyre.

3. Zbulimi i shpellave të reja dhe rezultatet e eksplorimit të tyre i bëhen të njohura, me raporte të hollësishme, Ministrisë së Mjedisit. Ministria u dërgon kopje të raportit Akademisë së Shkencave, universiteteve dhe organizatave jofitimprurëse të interesuara, si dhe autoriteteve vendore përkatëse. Eksploruesve u njihet dhe u sigurohet e drejta e autorësisë së zbulimit.

4. Shpellat mund të vizitohen, të përdoren për qëllime turistike ose mjekësore vetëm pasi të jenë përshtatur për këto veprimtari me autorizim dhe nën mbikëqyrjen e agjencive rajonale të mjedisit dhe të strukturave përkatëse të turizmit dhe pushtetit vendor. Përgatitja dhe përdorimi i tyre mund të bëhen nga subjekte publike ose private të pajisura me leje mjedisi. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat, të drejtat e detyrimet për dhënien e shpellave në përdorim. Eksplorimi, hyrjet e autorizuar dhe çdo përdorim i shpellave, duhet të sigurojnë mbrojtjen dhe pastërtinë e tyre, ruajtjen e mikroklimës, të regjimit ujor, të ekosistemeve, të tipareve gjeologjike dhe gjeomorfologjike, të gjetjeve paleontologjike e arkeologjike dhe të gjallesave.

5. Për shpellat, kanionet e ujëvarat zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

6. Shpellat, kanionet dhe ujëvarat natyrore nuk rrethohen me zonë buferike.

#### Neni 9

### **Rezervat natyror i menaxhuar (Zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve)**

1. Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i menaxhuar (zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve).

2. Në zonën e menaxhimit të habitateve dhe llojeve zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, ku ndalohen:

a) ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;

b) depozitimi i kimikateve;

c) lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;

ç) mbledhja e bimëve, mineraleve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve;

d) ngritja dhe funksionimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje.

dh) vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;

e) ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave të caktuara.

3. Veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji dhe çdo veprimtari tjetër, që nuk ndalohet nga ky nen, mund të ushtrohen, pasi të pajisen me leje mjedisi.

4. Zonë buferike e zonës së menaxhimit të habitateve dhe llojeve mund të shpallet territori rreth saj, me gjerësi 50 m nga kufiri i zonës.

5. Për shfrytëzimet turistike të formacioneve natyrore, të cilat ndodhen në këtë rezervat, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, si dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit të miratojnë rregulla të qëndrueshme dhe të kontrollueshme për kalime vizitorësh (turistë) vetëm për afate kohore të shkurtra, duke respektuar masat mbrojtëse të shkallës së tretë.

#### Neni 10

### **Peizazhi i mbrojtur**

1. Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.

2. Në një peizazh të mbrojtur zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, ku ndalohen:
  - a) mbjellja e pyjeve monokulturë;
  - b) neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;
  - c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase;
  - ç) gjuetia me ushqime të helmuara;
  - d) ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane;
  - dh) lëvizja me mjete transporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara. Ky rregull nuk zbatohet për automjetet dhe makineritë shtetërore, bujqësore e pyjore, të zjarrfikësve, autoambulancave, makinerive të shërbimeve veterinarë dhe atyre të menaxhimit të ujërave;
  - e) organizimi i garave me automjete, motoçikleta e biçikleta.
3. Veprimtaritë që ndryshojnë përdorimin e territorit, ndërtimet, përdorimi i kimikateve e pesticideve, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, për zona më të mëdha se 2 ha dhe veprimtaritë e tjera, që nuk ndalohen shprehimisht nga pika 2 e këtij neni, mund të ushtrohen vetëm pasi të jenë pajisur me leje mjedisi dhe të miratohen në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 11

### **Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara**

1. Zonat që përfshijnë territore të gjëra e, relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.

Hyrja e kufizuar në to nënkupton që këto zona, normalisht, do të kërkojnë kontroll, i cili do të varet nga presionet për të hyrë dhe përdorur zonën.
2. Kjo kategori mund të përdoret dhe për ato zona që janë të mbrojtura me legjislacion, por që nuk janë përdorur për ndonjë arsye.
3. Në një zonë të mbrojtur të burimeve të menaxhuara zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

#### Neni 12

### **Pyjet, ujërat dhe pasuri të tjera natyrore brenda zonave të mbrojtura**

1. Pyjet në zonat e mbrojtura përjashtohen nga klasifikimi si pyje për shfrytëzim.
2. Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera pronë shtetërore, që ndodhen brenda një zone të mbrojtur, bëhen nga administrata e ruajtjes së zonës. Administrata këto veprimtari i ushtron drejtpërdrejt ose nëpërmjet një subjekti të autorizuar prej saj.
3. Kur këto pasuri janë pronë private, ato menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me planin e menaxhimit të zonës, të miratuar nga Ministria e Mjedisit.
4. Dispozitat për ndërhyrjet kundër dëmtuesve dhe sëmundjeve që sjellin dëme në pyjet ose në ujërat e zonave të mbrojtura zbatohen vetëm me miratimin e administratës së zonës përkatëse dhe në shkallën e përcaktuar prej saj.

#### Neni 13

### **Shpallja dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura**

1. Shpallja e një zone të mbrojtur dhe e zonës së saj buferike bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Mjedisit, pas marrjes së mendimit nga organet e qeverisjes vendore, nga institucionet e specializuara, nga organizatat jofitimprurëse dhe nga pronarët privatë, kur në zonën e mbrojtur do të përfshihen edhe pronat e tyre.

2. Këshilli i Ministrave miraton procedurat për propozimin dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike. Ato përgatiten nga Ministria e Mjedisit në mbështetje të kriterëve të konventës së biodiversitetit, të udhëzimeve përkatëse të Bashkimit Europian dhe të planeve e strategjive mjedisore kombëtare.

3. Çdo person fizik a juridik ka të drejtë t'i kërkojë ministrisë që territori i vet privat ose pjesë e objekteve natyrore të veta, të shpallen ose të përfshihen në njërën nga kategoritë e zonave të mbrojtura.

#### Neni 14

### **Shpallja e zonave të mbrojtura**

1. Në propozimin për të shpallur një zonë të mbrojtur do të përfshihen të paktën:

a) argumentimi për krijimin e zonës së mbrojtur, si i mbështet objektivat e planit të administrimit të rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, epërsitë dhe mangësitë e krijimit të zonës dhe kategorinë e propozuar të mbrojtjes;

b) rezultatet e procesit të këshillimit me grupet e interesuara të shoqërisë civile, veçanërisht miratimi nga bashkësia vendore, brenda dhe rreth zonës së propozuar, duke përfshirë komentet e marra dhe reflektimet në propozim;

c) një vëzhgim fizik i vendit të propozuar;

ç) një vlerësim i ndikimit në mjedis, duke përfshirë identifikimin e proceseve dhe të kategorive të veprimtarive, të cilat mund ta kërcënojnë diversitetin biologjik dhe attribute të tjera të vendit të propozuar, duke përfshirë zonat përreth;

d) një vëzhgim të ndikimit shoqëror dhe ekonomik të popullatës vendore, që përfshin përdorimin e zonës së propozuar dhe ndikimin e mundshëm të zonës së mbrojtur në këto përdorime;

dh) një përshkrim të masave kompensuese, që mund të nevojiten të merren për të adresuar transferimin e pronësisë dhe të të drejtave për përdorimin e elementëve të diversitetit biologjik.

2. Organet shtetërore marrin masa të përkohshme për mbrojtjen dhe administrimin sipas rastit.

#### Neni 15

### **Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur**

1. Ministria e Mjedisit, organet e tjera shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore ose në bashkëpunim me të tretët, hartojnë për secilën zonë të mbrojtur planet e menaxhimit të kësaj zone.

2. Të gjitha planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur, që nuk janë hartuar nga Ministria e Mjedisit, duhet të miratohen nga kjo Ministri, për të siguruar përputhshmërinë me objektivat e këtij ligji ose të ligjeve të tjera që lidhen me të.

3. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur do të përfshihen në politikat, planet, programet dhe veprimtaritë qeveritare, që lidhen me to, dhe në vendimmarrjen në nivele kombëtare, rajonale ose vendore.

4. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur do të përfshijnë të paktën:

a) objektivat e menaxhimit të zonës së mbrojtur;

b) mekanizmat dhe autoritetin drejtues, si të Ministrisë së Mjedisit, ashtu edhe të organeve të tjera shtetërore ose të organizatave të tjera ose personave juridikë e fizikë;

c) proceset dhe kategoritë e veprimtarive, të cilat kërcënojnë ose janë kërcënuese për zonën e mbrojtur, duke përfshirë edhe zonat rrethuese;

ç) masat rregullatore ose administrative që nevojiten për të shmangur ose pakësuar kërcënimet e identifikuar;

d) veprimtaritë e lejuara brenda zonës së mbrojtur;

dh) veprimtaritë e duhura për zonat përreth, duke përfshirë ato në zonat buferike dhe më tej;

e) kushtet për kontrollin e turizmit dhe të shërbimeve të tjera;

ë) të dhënat për pronësinë e mëparshme të truallit dhe të drejtat për të përdorur elementët e diversitetit biologjik brenda tij, duke përfshirë veprimtaritë tradicionale për jetesën e popullatës ose të bashkësisë vendore;

f) kushtet për të zhvilluar veprimtari tradicionale për jetesë, të zonës ose të elementëve të diversitetit biologjik brenda saj, nëse ato nuk bien ndesh me objektivat e administrimit të zonës së mbrojtur;

g) kushtet për të ndarë përfitimet nga krijimi dhe administrimi i zonës së mbrojtur, veçanërisht, me bashkësitë dhe popullatat vendore;

gj) kushtet për kërkim shkencor, inventarizim dhe monitorim;

h) burimet financiare, duke përfshirë ato që sjellin fitim;

i) kushte të tjera të veçanta për zonën në fjalë.

5. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur do të rishihen dhe do të ripunohen periodikisht, në përputhje me nevojat e kohës.

#### Neni 16

### **Detyrat e Ministrisë së Mjedisit për shpalljen e zonave të mbrojtura**

Ministria e Mjedisit:

a) harton dhe publikon planin e zonave, që do të shpallen të mbrojtura, pasi merr edhe mendimin e organeve të qeverisjes vendore;

b) jep njoftime publike për zonat e mbrojtura, të miratuara, për monumentet natyrore, për drurët e mbrojtur, për llojet e bimëve dhe të kafshëve, veçanërisht të mbrojtura, për gjetjet minerare dhe paleontologjike, duke përcaktuar me hollësi kushtet për mbrojtjen e tyre;

c) miraton dhe shpall planet për menaxhimin e zonave të mbrojtura, si dhe programet për mbrojtjen e llojeve të bimëve dhe kafshëve, veçanërisht të rrezikuara, për burimet ujore dhe liqenet natyrore e artificiale në këto zona.

2. Planet e menaxhimit dhe programet e mbrojtjes hartohen në bashkëpunim me institucionet administruese dhe me pronarët e objekteve të përfshira në zonat e mbrojtura.

3. Pronarët dhe përdoruesit e tokës, që do të shpallet zonë e mbrojtur, si dhe çdo person ose autoritet, që ka interesa në zonë, kanë të drejtë të ngrenë kundërshtime ndaj synimit për ta shpallur zonë të mbrojtur. Kundërshtimet paraqiten me shkrim në Ministrinë e Mjedisit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të synimit.

4. Ministria e Mjedisit shqyrton kundërshtimet dhe, brenda 1 muaji, njofton të interesuarit për vendimin e marrë. Kundër vendimit të Ministrisë, të interesuarit kanë të drejtë, brenda 15 ditëve, të ankohen në gjykatën e rrethit.

5. Nga njoftimi i planit për shpalljen e një territori zonë e mbrojtur e deri në hyrjen në fuqi të vendimit që e shpall atë zonë të mbrojtur, pronarëve dhe përdoruesve të tokës, pyjeve, kullotave, u ndalohen ndërhyrjet, që ndryshojnë ose dëmtojnë gjendjen dhe vlerat natyrore të territorit, të propozuar për mbrojtje.

#### Neni 17

### **Zbatimi i planit të menaxhimit**

1. Planet e menaxhimit dhe programet e mbrojtjes zbatohen nga administrata e ruajtjes së zonës.

2. Për të ndjekur zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura ngrihen komitetet e menaxhimit. Përbërja, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre komiteteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Për zbatimin e planeve të menaxhimit mund të angazhohen institucione publike dhe private, persona juridikë, vendas ose të huaj, organizata jofitimprurëse mjedisore, duke zbatuar rregullat dhe procedurat e konkurrimit e të tenderimit.

## Neni 18

### **Pronësia në zonat e mbrojtura**

1. Zonat e mbrojtura shpallen ato territore që janë pronë publike, bashkiake, komunale dhe në raste të veçanta pronë private.

2. Për interesa të veçantë të mbrojtjes së natyrës e biodiversitetit, në përbërje të zonave të mbrojtura përfshihen edhe toka, pyje, kullota, etj., private, duke marrë, në çdo rast, pëlqimin e pronarit.

3. Territoret dhe objektet private, të përfshira në zonat e mbrojtura, mbeten pronë e pronarit privat. Ato administrohen e përdoren prej tij ose prej përdoruesit të ligjshëm, vetëm sipas kërkesave të planit të menaxhimit të zonës, të miratuar nga Ministria e Mjedisit.

4. Pronarëve privatë, prona e të cilëve përfshihet brenda territorit të zonës së mbrojtur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, u njihet e drejta e administrimit dhe përdorimit të saj, sipas kërkesave të planit të menaxhimit. Në rast se pronarët nuk janë dakord, kanë të drejtë të kërkojnë kompensimin me vlerë ose me një sipërfaqe tjetër ose ia shesin shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Monumentet natyrore, pronë publike, janë të patjetërsueshme.

## Neni 19

### **Përdoruesit e zonave të mbrojtura**

1. Pronarët privatë, pronat e të cilëve janë përfshirë në zonën e mbrojtur, si dhe përdoruesit e këtyre pronave marrin pjesë në planifikimin, ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore të zonës. Ata detyrohen të bashkëpunojnë me administratën e zonës dhe të zbatojnë me përpikëri rregullat e caktuara, planet e menaxhimit dhe programet e hartuara për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

2. Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje me planin e menaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit. Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj, zbatohet ligji nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

3. Veprimtaritë ekonomike e shoqërore, projektet që synojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur, pajisen me leje mjedisi, pasi të paraqesin studimin përkatës dhe raportin e plotë të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

4. Të gjitha ndërtimet publike, private e turistike në territorin e zonave të mbrojtura, bëhen në bazë të studimeve dhe planeve rregulluese të përgjithshme, të cilat miratohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

5. Administrata e zonave të mbrojtura, inspektorët e mjedisit, organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe atë ndërtimore ndalojnë zbatimin e projekteve e të veprimtarive me ndikim në mjedis dhe që bien ndesh me planin e menaxhimit të zonës.

6. Personat juridikë e fizikë, që kryejnë veprimtari të lejuara në territorin e zonave të mbrojtura, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar të lidhin kontratë me institucionet administruese për ushtrimin e veprimtarisë, kundrejt pagesave përkatëse.

## Neni 20

### **Monitorimi i zonave të mbrojtura**

1. Ministria e Mjedisit harton objektivat e monitorimit të zonave të mbrojtura, drejton organizimin dhe realizimin e tyre dhe përpunon e publikon rezultatet e monitorimit.

2. Në zbatimin e programeve të monitorimit, Ministria angazhon institucione publike ose private në përputhje me rregullat e procedurat e konkurrimit e të tenderimit. Subjektet e angazhuara në monitorim dërgojnë në Ministri të dhënat e monitorimit.

3. Subjektet që kryejnë veprimtari të lejuar në zonat e mbrojtura janë të detyruara të monitorojnë, sipas kërkesave të programit të monitorimit të zonës dhe të publikojnë të dhënat e këtij monitorimi.

#### Neni 21

##### **Skedimi dhe shënimi i zonave të mbrojtura**

1. Ministria e Mjedisit përcakton mënyrën e shënimit të zonave të mbrojtura në terren dhe në harta.
2. Për markimin dhe shënimin e zonave të mbrojtura përdoret stema e Republikës së Shqipërisë.
3. Ministria e Mjedisit njofton organet përkatëse gjeodezike dhe kartografike për çdo shpallje, ndryshim ose heqje të statusit të çdo zone të mbrojtur.
4. Zonat e mbrojtura shënohen në skedarin qendror të Ministrisë së Mjedisit, i cili do të ngrihet duke shfrytëzuar të dhënat e institucioneve përkatëse shtetërore dhe të institucioneve të tjera të specializuara.
5. Ministria e Mjedisit harton dhe miraton rregullat për ndërtimin, funksionimin dhe shfrytëzimin e skedarit qendror.
6. Skedari qendror është publik dhe kushdo mund ta përdorë me leje dhe në prani të punonjësit të autorizuar.

#### Neni 22

##### **Heqja dhe ndryshimi i statusit të zonës së mbrojtur dhe zonës së saj buferike**

1. Një zone të mbrojtur i hiqet ose i ndryshohet statusi i mbrojtjes, sipas këtij ligji, kur kanë ndryshuar rrethanat dhe qëllimi për të cilat ajo e fitoi këtë status.
2. Heqja e statusit të një zone të mbrojtur bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Mjedisit, pas marrjes së mendimit nga institucionet e specializuara, organet e qeverisjes vendore, organizatat jofitimprurëse dhe nga pronarët privatë kur në zonën e mbrojtur do të përfshihen edhe pronat e tyre.
3. Me heqjen e statusit të një zone të mbrojtur pushon së qeni edhe zona e saj buferike.
4. Në propozimin për heqjen e statusit të një zone të mbrojtur do të përfshihen:
  - a) argumentimi për heqjen e statusit;
  - b) vlerësimi i ndikimit në mjedis, që pasqyron ndikimin në kategorizimin ekzistues të zonës së mbrojtur në biodiversitetin dhe popullatat ose bashkësitë vendore;
  - c) përshkrimi i masave zbutëse;
  - ç) rezultatet e proceseve të bashkërendimit dhe këshillimit me grupet e interesit të shoqërisë civile, veçanërisht me popullatat ose bashkësitë brenda dhe përreth zonës së mbrojtur, duke përfshirë një përmbledhje të komenteve të marra dhe reflektimin në propozim.

#### Neni 23

##### **Administrata e zonës së mbrojtur**

1. Autoriteti shtetëror, i ngarkuar për administrimin e zonave të mbrojtura (administrata e zonës së mbrojtur), caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Përbërja, struktura, detyrat, përgjegjësitë dhe funksionimi i administratës për çdo kategori të zonave të mbrojtura, miratohen nga Këshilli i Ministrave.
3. Me miratimin e këtij ligji strukturat e ngritura deri më sot për administrimin e zonave të mbrojtura kalojnë, gradualisht, në varësi të institucioneve të përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij neni.
4. Ministria e Mjedisit, me miratimin e Këshillit të Ministrave, mund të marrë në administrim zona të mbrojtura dhe në varësi administratën e saj.

#### Neni 24

### **E drejta për të vizituar zonat e mbrojtura**

Kushdo ka të drejtë të vizitojë zonat e mbrojtura, me kusht që të respektojë të drejtat e ligjshme të pronarit ose të përdoruesit të tokës, detyrimet ligjore, që rrjedhin nga ky ligj, rregullat e vendosura nga administrata e ruajtjes së zonës dhe ligjet e tjera, që përcaktojnë detyrime ligjore për ruajtjen e pronës.

#### Neni 25

### **Veprimtaritë në zonat e mbrojtura**

1. Në zonat e mbrojtura mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore etj., sipas kërkesave të këtij ligji.

2. Organet qendrore dhe të pushtetit vendor nxitin dhe përkrahin nisma, projekte, programe e veprimtari, që synojnë përmirësimin e treguesve ekologjikë e natyrorë të një zone të mbrojtur ose që ndikojnë pozitivisht në to.

3. Në zonat e mbrojtura, veprimtaritë mund të ushtrohen vetëm pasi të jetë marrë më parë leja e mjedisit ose pasi të jetë marrë miratimi i organit të mbrojtjes së zonës, në rastet kur kjo kërkohet shprehimisht nga ky ligj.

#### Neni 26

### **Objektivat e rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura**

Objektivat e përgjithshëm të rrjetit përfaqësues janë:

a) të mbrojnë drejtimit e zhvillimit të tanishëm dhe të ardhshëm të vendit nëpërmjet ruajtjes dhe, kur është e nevojshme, nëpërmjet restaurimit të ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve përfaqësuese, si edhe integritimit të administrimit të tyre në politikat, planet, programet dhe veprimtaritë qeveritare, në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor;

b) të sigurojë përdorimin e qëndrueshëm të elementëve të diversitetit biologjik, nëpërmjet përfshirjes së bashkësive vendore në vendimarrje dhe veprimtari të tjera që lidhen me zonat e mbrojtura, që përfshijnë caktimin dhe përvijëzimin e zonave, hartimin e planeve të administrimit të integruar dhe drejtimin e zonave të mbrojtura.

#### Neni 27

### **Zhvillimi, planifikimi, bashkërendimi dhe drejtimi i rrjetit përfaqësues**

1. Ministria e Mjedisit bashkërendon ngritjen e rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura.

2. Planifikimi, bashkërendimi dhe drejtimi i rrjetit përfaqësues specifikohen në një plan administrimi të rrjetit, që ripunohet periodikisht dhe u vihet në dispozicion organeve shtetërore dhe shoqërisë civile.

3. Plani i administrimit të rrjetit përfaqësues përfshin:

a) objektivat e rrjetit;

b) kontributin e secilës zonë të mbrojtur në arritjen e objektivave të rrjetit përfaqësues dhe atyre të rrjetit ekologjik;

c) mangësitë në mbulimin e të gjitha zonave me vlerë në rrjetin përfaqësues;

ç) planveprimin për të zbatuar dhe zhvilluar më tej rrjetin përfaqësues.

4. Buxhetet që mbështesin ngritjen e rrjetit përfaqësues, por edhe të zonave të mbrojtura, sigurohen nga burime financiare shtetërore dhe nga donatorët.

Neni 28

### **Dispozita të përgjithshme për zonat e mbrojtura**

Krijimi i zonave të mbrojtura bëhet në përputhje me planin e administrimit të rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura dhe me planin e administrimit të rrjetit ekologjik të vendit.

Neni 29

### **Objektivat e rrjetit ekologjik**

Rrjeti ekologjik shqiptar krijohet për të mbajtur ose rivendosur një status të favorshëm ruajtjeje për ekosistemet, habitatet dhe peizazhet.

Neni 30

### **Elementet e rrjetit ekologjik**

Rrjeti ekologjik formohet nga:

a) zona e vet qendrore, me rëndësi botërore, rajonale dhe kombëtare për ruajtjen e diversitetit biologjik, që përfshijnë ekosisteme natyrore e gjysmënatyrore, habitate dhe peizazhe. Zona qendrore përfshin elementë të rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura;

b) korridoret, për të përmirësuar lidhjen e zonave qendrore, duke mbështetur lëvizjen e llojeve;

c) zonat e restaurimit ose të rehabilitimit;

ç) zonat buferike, për të mbështetur dhe mbrojtur rrjetin ekologjik nga ndikimet e jashtme dhe ku brenda tyre të promovohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe ekologjik.

Neni 31

### **Zhvillimi, planifikimi, bashkërendimi dhe drejtimi i rrjetit ekologjik**

Ministria e Mjedisit bashkërendon në ngritjen e rrjetit ekologjik.

2. Planifikimi, bashkërendimi dhe drejtimi i rrjetit ekologjik specifikohen në një plan administrimi të rrjetit, i cili ripunohet periodikisht dhe vihet në dispozicion të organeve shtetërore dhe shoqërisë civile.

Plani i administrimit të rrjetit përcakton:

a) objektivat e rrjetit;

b) kontributin e secilit element të rrjetit për të arritur këta objektiva;

c) mangësitë e rrjetit;

ç) planveprimin për të arritur objektivat.

4. Plani i administrimit të rrjetit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Politikat, planet dhe programet qeveritare, si edhe vendimmarrja në nivele kombëtare, rajonale dhe vendore sigurojnë integritetin e rrjetit ekologjik.

Neni 32

### **Sanksionet**

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative.

2. Llojet e shkeljeve dhe të masave, si dhe subjektet që konstatojnë shkeljet dhe japin masat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33  
**Aktet nënligjore**

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministritë përkatëse të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 34  
**Shfuqizime**

Nenet 12, 20 pika 2, 37 pika 2 dhe 41 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 "Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor", si dhe nenet 8 shkronja "c", 10 dhe 13 të ligjit nr.7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë" shfuqizohen.

Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3380, datë 24.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**LIGJ**  
**Nr. 8908, datë 6.6.2002**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8308, DATË 18.3.1998 "PËR TRANSPORTET RRUGORE"**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Arben Malaj,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 35, rreshti i parë ndryshohet si më poshtë:  
"Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë ose i komunës përkatëse".

Neni 2

Në nenin 36, paragrafi i dytë rreshti i parë, pas fjalëve "Këshilli i bashkisë" shtohen fjalët "dhe këshilli i komunës".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3374, datë 24.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**LIGJ**  
**Nr. 8813, datë 13.6.2002**

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.3.1995 "KODI I  
PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Neni 13 ndryshohet si vijon:

"Neni 13

**Gjykatat penale të shkallës së parë dhe përbërja e tyre**

1. Veprat penale gjykohen në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatat për krime të rënda , gjykatat ushtarake dhe Gjykata e Lartë, sipas rregullave dhe përgjegjësive të caktuara në këtë Kod.

2. Në gjykatat e rretheve gjyqësore gjykohen nga një gjyqtar:

a) veprat penale për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet;

b) kërkesat e palëve gjatë hetimit paraprak;

c) kërkesat për ekzekutimin e vendimeve;

ç) kërkesat për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.

Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

3. Gjykatat për krimet e rënda gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë.

4. Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit."

Neni 2

Neni 14 ndryshohet si vijon:

"Neni 14

**Gjykatat e apelit dhe përbërja e tyre**

1. Gjykatat e apelit shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

2. Gjykata ushtarake e apelit shqyrton në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykatat ushtarake.

3. Seksionet përkatëse të Gjykatës së Apelit Tiranë shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata e krimeve të rënda."

### Neni 3

Pas nenit 14 shtohet neni 14/a me këtë përmbajtje:

#### "Neni 14/a Gjykata e Lartë dhe përbërja e saj

1. Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë dhe në kolegje të bashkuara. "

### Neni 4

Në nenin 21, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në seancë nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankimi së bashku me vendimin përfundimtar të çështjes."

### Neni 5

Në nenin 24, në fund të pikës 5 shtohen fjalët "me ankim ose kryesisht".

### Neni 6

Në nenin 27, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"1. Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë shkronjat "a", "b", "ç", "d" dhe "dh". Në rastet e tjera prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij."

### Neni 7

Në nenin 34, pas pikës 3 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"4. Dispozitat, që zbatohen për të pandehurin, zbatohen edhe për personin nën hetim, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe. Ndaj këtij personi shtrihen edhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të pandehurin."

### Neni 8

Në nenin 58, pas pikës 2 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"3. I dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e dëgjimit."

### Neni 9

Në nenin 59, pas pikës 2 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"3. Nëse i dëmtuari akuzues ose mbrojtësi i caktuar prej tij nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimit."

### Neni 10

Në nenin 62, pas pikës 2 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"3. Me kërkesën e palëve ose kryesisht, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal."

Neni 11

Neni 74 ndryshohet si vijon:"

Neni 74

#### **Kompetencat e gjykatës së rrethit gjyqësor**

1. Gjkata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së gjykatës për krime të rënda, gjykatës ushtarake dhe Gjykatës së Lartë."

Neni 12

Neni 75 ndryshohet si vijon:"

Neni 75

#### **Kompetencat e gjykatës ushtarake**

1. Gjkata ushtarake është kompetente për gjykimin e ushtarakëve, robërve të luftës dhe personave të tjerë, për veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak dhe dispozita të tjera ligjore, përveç atyre që i përkasin kompetencës të gjykatës së krimeve të rënda dhe Gjykatës së Lartë."

Neni 13

Pas nenit 75 shtohet neni 75/a me këtë përmbajtje:

"Neni 75/a

#### **Kompetencat e gjykatës për krime të rënda**

1. Gjkata e krimeve të rënda gjykon krimin e krijimit të bandës së armatosur dhe të organizatës kriminale, krimet e kryera prej tyre, çdo krim që dënohet në minimum jo më pak se 15 vjet burgim, si dhe krimet e parashikuara nga nenet 140 dhe 284/a të Kodit Penal, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga subjekte që janë në kompetencë të gjykatave ushtarake dhe nga të miturit."

Neni 14

Pas nenit 75/a shtohet neni 75/b me këtë përmbajtje:

"Neni 75/b

1. Gjkata e Lartë shqyrton rekurset për shkelje të ligjit dhe kërkesat për rishikimin e vendimeve të formës së prerë.

2. Gjkata e Lartë gjykon në shkallë të parë, me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimin."

#### Neni 15

Në nenin 79 bëhen këto ndryshime:

1. Në fillim të nenit fjalët "1. Ka bashkim procedimesh:" zëvendësohen me fjalët "1. Organi procedues mund të vendosë bashkimin e procedimeve:".

2. Në shkronjën "b" fjalët "të kryera me një veprim a mosveprim të vetëm ose me disa veprime a mosveprime për arritjen e një qëllimi të vetëm kriminal;" zëvendësohen me fjalën "penale".

#### Neni 16

Neni 80 ndryshohet si vijon:

"Neni 80

#### **Bashkimi i procedimeve që janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme**

1. Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë kompetencë e gjykatës për krimet e rënda dhe procedurat e tjera në kompetencë të gjykatave të tjera të shkallës së parë, kompetente është gjykata e krimeve të rënda.

2. Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë në kompetencë të gjykatave të shkallës së parë dhe të tjerat në kompetencë të Gjykatës së Lartë, kompetente është kjo e fundit."

#### Neni 17

Në nenin 94, fjalët "të procesit" zëvendësohen me fjalët "të gjykimit", ndërsa fjalët "të caktuar sipas nenit 76" hiqen.

#### Neni 18

Në nenin 112, pika 2 ndryshohet si vijon:

"2. Vendimi jepet në emër të Republikës".

#### Neni 19

Në nenin 158, paragrafi i parë shkronja "a" fjalët "- të afërmit e të pandehurit" zëvendësohen me fjalët "- gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit, sipas përcaktimeve të nenit 16".

#### Neni 20

Në nenin 179 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, në fjalinë e fundit, pas fjalëve "ekspertimi shpallet i pavlefshëm" shtohen fjalët "ose duhet të bëhet ekspertim i ri,".

2. Në fund të paragrafit 4 shtohen fjalët "ose kur pretendon se nuk është kompetent ose nuk ka mundësi të kryejë ekspertimin dhe kërkesa e tij pranohet nga organi procedues".

#### Neni 21

Në nenin 184 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Kur për nevojat e ekspertimit është i domosdoshëm shkatërrimi ose ndryshimi i thelbit të sendit, kur është e mundur, ekspertët detyrohen të ruajnë atë pjesë të tij, si dhe të dokumentojnë pjesën e përdorur për ekspertim, duke vënë në dijeni organin procedues dhe palët."

#### Neni 22

Në nenin 221 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët "ose i" zëvendësohen me shenjën e pikësimit", "
2. Në fund të këtij neni shtohet një pikë me këtë përmbajtje:  
"2. Përgjimi, i përcaktuar në pikën 1 më sipër është i vlefshëm për të gjithë komunikuesit."

#### Neni 23

Në nenin 222 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të fjalisë së fundit të paragrafit 1 shtohet fjala "i veçantë".
2. Fjala e dytë e pikës 3 ndryshohet si vijon:  
"Ky afat, me kërkesë të prokurorit, mund të zgjatet nga gjykata sa herë është e nevojshme, për një periudhë prej 20 ditësh kur procedohet për krime dhe 40 ditësh kur procedohet për krime të rënda."

#### Neni 24

Në nenin 223 pika 1 fjala "impiante" zëvendësohet me fjalën "pajisje" dhe pas fjalëve "në vende të caktuara" shtohet fjala "të autorizuara".

#### Neni 25

Në nenin 225, në fjalinë e parë fjalët "për të cilat është i detyrueshëm arrestimi në flagrancë" hiqen.

#### Neni 26

Neni 236 ndryshohet si vijon:

#### "Neni 236

#### **Garancia pasurore**

1. Garancia pasurore është depozitimi në bankë i një shume të hollash të caktuara nga gjykata, e cila do të kalojë në dobi të shtetit, nëse i pandehuri nuk paraqitet në organin procedues.
2. Paraprakisht gjykatës i paraqitet një deklaratë e nënshkruar nga i pandehuri ose një person tjetër që meriton besim, me të cilën ata deklarojnë se pranojnë të depozitojnë në bankë shumën e caktuar nga gjykata.
3. Pas paraqitjes së dokumentit të depozitimit të shumës dhe pas dëgjimit të prokurorit, gjykata urdhëron zbatimin e vendimit.
4. Në rast mosparaqitjeje shuma e depozituar kalon me vendim të gjykatës në dobi të shtetit."

#### Neni 27

Në nenin 244, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Gjkata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori."

## Neni 28

Në nenin 246 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

"2. Në rast se dyshohet për vërtetësinë e vendimit që ka caktuar masën e sigurimit ose për vërtetësinë e identitetit të personit ndaj të cilit është dhënë masa, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të ngarkuar nuk e zbatojnë atë."

2. Pika 6 ndryshohet si vijon:

"6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet nga prokurori për të arrestuarin. Informacioni jepet me shkrim dhe përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, për pyetjen e të pandehurit dhe të personave të tjerë, për përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur është rasti, gjykata mund të revokojë ose të zëvendësojë masën e sigurimit."

## Neni 29

Në nenin 249 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

"1. Brenda dhjetë ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës, në bazë të të cilit është marrë ose është refuzuar një masë sigurimi, prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë."

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

"3. Kërkesa paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimuar, e cila detyrohet që brenda 5 ditëve të dorëzojë aktet në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin."

3. Pika 5 ndryshohet si vijon:

"5. Kërkesa shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve."

4. Pika 9 ndryshohet si vijon:

"9. Me kalimin e gjashtë muajve nga zbatimi i vendimit të arrestit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë."

## Neni 30

Në nenin 255, në pikën 1 fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

"Ata i bëjnë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklarata dhe në qoftë se do të flasë, çfarëdo që ai thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore i bëjnë të ditur të ndaluarit ose të arrestuarit edhe të drejtën që ai ka për të zgjedhur mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose, kur është rasti, atë të caktuar nga prokurori."

## Neni 31

Në nenin 258, në pikën 1 fjalët "njëzet e katër orëve" zëvendësohen me fjalët "dyzet e tetë orëve".

## Neni 32

Në nenin 259 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 2 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Provat e marra në këtë seancë konsiderohen si të marra në gjykim."

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Kur del se arrestimi ose ndalimi janë bërë në mënyrë të ligjshme, gjykata merr vendim për vleftësimin e masës.

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet apel në gjykatën më të lartë nga prokurori dhe i arrestuari ose i ndaluari dhe, kur ka kërkesë nga prokurori, gjykata cakton masën e sigurimit."

3. Në pikën 5, fjalët "njëzet e katër orëve" zëvendësohen me fjalët "dyzet e tetë orëve".

#### Neni 33

Në nenin 263 shtohen pikat 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

"7. Kur në mbarim të afatit të paraburgimit prokurori i komunikon të pandehurit një akuzë të re, për të cilën parashikohen afate më të gjata paraburgimi se ato të akuzës së parë, ai i kërkon gjykatës të caktojë afatin e ri të paraburgimit. Gjkata vendos në seancë gjyqësore pasi të ketë dëgjuar palët.

8. Kur akuza e re lidhet me një fakt të ri, që nuk dihej në fillim të procedimit, gjykata cakton një afat të ri, i cili fillon të llogaritet nga e para, ndërsa kur ndryshon vetëm cilësimi ligjor i veprës penale, gjykata cakton masën e sigurimit dhe fillimi i llogaritjes së afatit është ai i masës së mëparshme të sigurimit."

#### Neni 34

Në nenin 277, pas pikës 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"3. Për veprat penale që gjykohen në shkallë të parë nga Gjykata e Lartë, procedohet nga Prokuroria e Përgjithshme."

#### Neni 35

Në nenin 278, pas pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"2. Të gjitha veprimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar."

#### Neni 36

Në nenin 284, në paragrafin e parë hiqet numri "85".

#### Neni 37

Në nenin 310, pas pikës 1 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"2. Kur i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë njoftuar rregullisht, por nuk janë të pranishëm pa shkak të arsyeshëm, caktohet një mbrojtës kryesisht. Kjo gjendje pasqyrohet në procesverbalin përkatës."

#### Neni 38

Në nenin 320, në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve. Gjkata e apelit e shqyrton ankesën brenda 10 ditëve nga dorëzimi i akteve në këtë gjykatë."

#### Neni 39

Në nenin 342, pas pikës 3 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"4. Kur për shkaqe të përligjura ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç rastit kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me tre gjyqtarë dhe më shumë se dy nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me pesë gjyqtarë, gjykimi fillon nga e para."

#### Neni 40

Në nenin 344, pas pikës 3 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"4. Mungesa e të pandehurit që largohet nga salla dhe nuk ka pranuar të ketë mbrojtës, nuk e pengon zhvillimin e gjykimit. Në këtë rast caktohet një mbrojtës kryesisht dhe vazhdon gjykimi. I pandehuri ose mbrojtësi i caktuar prej tij mund të pranohet në sallë në çdo kohë."

#### Neni 41

Në nenin 362 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve "përmbajtjen e dëshmisë" shtohen fjalët "ose kur refuzon të dëshmojë".

2. Në pikën 2, pas fjalëve "Këto thënie nuk përbëjnë provë" shtohen fjalët "në vetvete".

3. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

"3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

4. Deklarimet e mëparshme, të përfshira në fashikullin e gjykimit, sipas pikës 2 të këtij neni, çmohen si prova edhe kur rezultojnë se dëshmitari qoftë edhe gjatë pyetjes në seancë i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t'i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme, si dhe kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë dëmtonuar sinqeritetin e përgjigjeve të tij."

#### Neni 42

Në nenin 364, në fund të pikës 1 fjalët "të pandehurit dhe mbrojtësit të tij" zëvendësohen me fjalën "të palëve".

#### Neni 43

Në nenin 369, në fund të pikës 3 shtohen fjalët "ose kur nuk gjendet, me gjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore, si dhe kur refuzon të dëshmojë. Në këtë rast akti vlerësohet duke u lidhur me provat e tjera."

#### Neni 44

Në nenin 370, në pikën 2 pas fjalës "të paraqitur" shtohen fjalët "ose refuzon të përgjigjet për deklaratimet që ka bërë në prani të mbrojtësit".

#### Neni 45

Neni 375 ndryshohet si vijon:

"Neni 375

#### **Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale**

1. Me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj."

#### Neni 46

Në nenin 390, në pikën 2 fjalët "konkurrimin e veprave penale" zëvendësohen me fjalët "bashkimin e".

Neni 47

Në nenin 400, në pikën 1 fjalët "njëzet e katër orëve" zëvendësohen me fjalët "dyzet e tetë orëve".

Neni 48

Në nenin 404, pika 2 shfuqizohet.

Neni 49

Në nenin 406, pika 1 ndryshohet si vijon:

"1. Kur jep vendim dënimi, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. Dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me njëzet e pesë vjet burgim."

Neni 50

Në nenin 410, në pikën 2 pas fjalës "lëshuar" shtohen fjalët "nga i pandehuri".

Neni 51

Në nenin 424, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Mbi ankimin e bërë kundër vendimeve të gjykatës për krimet e rënda vendos Gjykata e Apelit Tiranë."

Neni 52

Neni 431 ndryshohet si vijon:

"Neni 431

**Rekursi i drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë**

1. Janë objekt rekursi të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë vendimet e gjykatës për mosmarrëveshjet lidhur me juridiksionin dhe kompetencat, si dhe rastet e veçanta të parashikuara me ligj."

Neni 53

Neni 432 ndryshohet si vijon:

"Neni 432

**Rekursi kundër vendimeve të formës së prerë**

1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:

- a) për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal;
- b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi;
- c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit."

Neni 54

Në nenin 437, në pikën 1 fjala "tre" zëvendësohet me fjalën "pesë"

Neni 55

Neni 438 ndryshohet si vijon:

"Neni 438

**Njehsimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore**

1. Kur lind nevoja për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të ardhura për gjykim në Kolegjin Penal.
2. Tërheqja e çështjeve bëhet me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Penal.
3. Kolegjet e bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin.
4. Vendimi i kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme."

Neni 56

Në nenin 441, në pikën 1 pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë."

Neni 57

Në nenin 452 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët "në sekretarinë e gjykatës së rrethit që ka dhënë vendimin" zëvendësohen me fjalët "në sekretarinë e Gjykatës së Lartë".
2. Në pikën 3, fjalët "kryetari i gjykatës së rrethit" zëvendësohen me fjalët "Kryetari i Kolegjit Penal".

Neni 58

Neni 453 ndryshohet si vijon:

"Neni 453

**Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë**

1. Kërkesa e rishikimit shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve.
2. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 450 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë ose kur rezulton haptazi e pambështetur, Kolegji Penal vendos mospranimin e saj.
3. Kur kërkesa pranohet, Kolegji Penal vendos prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim nga një tjetër trup gjykues në gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Vendimi është i formës së prerë."

Neni 59

Neni 454 ndryshohet si vijon:

"Neni 454  
**Pezullimi i ekzekutimit**

1. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe gjykata e caktuar për rigjykimin e çështjeve mund të urdhërojnë pezullimin e ekzekutimit të vendimit.
2. Vendimi është i formës së prerë."

Neni 60

Në nenin 455, pika 1 ndryshohet si vijon:

"1. Gjykata, e caktuar për rigjykimin e çështjes, cakton datën e seancës gjyqësore dhe urdhëron thirrjen e palëve."

Neni 61

Në nenin 457, në pikën 1 fjala "e rrethit" dhe fjalët "dhe të mbajtjes në burg" hiqen.

Neni 62

Në nenin 458 dhe në pikën 5 të nenit 459 fjalët "në gjykatën e apelit" hiqen.

Neni 63

Në nenin 495, në pikat 2 dhe 3 fjalët "njëzet e katër orëve" zëvendësohen me fjalët "dyzet e tetë orëve".

Neni 64

Në nenin 514, në pikën 1 shkronja "e" shfuqizohet.

Neni 65

Në të gjitha dispozitat e këtij Kodi fjalët "Gjykata e Kasacionit" zëvendësohen me fjalët "Gjykata e Lartë", ndërsa fjalët "gjykata e rrethit" zëvendësohen me fjalët "gjykata e rrethit gjyqësor".

Neni 66

Dispozitat procedurale për gjykatat për krimet e rënda do të zbatohen pas hyrjes në fuqi të ligjit për caktimin e ditës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 67

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3382, datë 24.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 25.6.2002  
Doli nga shtypi më 26.6.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë